



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

## **DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

### **Raporti vjetor i punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport:**

#### **Subvencione**

Subvencionimi i klubeve sportive dhe projekteve sportive në vlerë 40,000 euro.

Subvencionimi i projekteve teatrore 31,000 euro.

Subvencionimi i projekteve në fushat e Kulturës dhe Rinisë 13,280 euro.

#### **Projekte kapitale**

Renovimi dhe hapja e galerisë së arteve.

Ndërtimi i stadiumit të futbollit në Peran i cili është në fazën përfundimtare.

Përfundimi i ndërtimit të fushave të reja të futbollit dhe basketbollit në Surkish, Lupç, Sibofc, Bajqinë dhe Gllamnik.

Ndërtimi i Fitnesit të Hapur, në parkun e qytetit.

Kemi nënshkruar marrëveshjen për ndërtimin e Qendrës Multifunktionale me Ministrinë e Kulturës, projekt i cili kapë vlerën 1.1 milion euro.

Ka përfunduar restaurimi i objektit të bibliotekës së qytetit. Pritet të hapet në vitin 2023.

Është caktuar lokacioni për ndërtimin e Pishinës së mbyllur Gjysmë-Olimpikë.

#### **Trashëgimia Kulturore**

Në kuadër të investimeve në trashëgiminë kulturore, është në përfundim restaurimi i objektit me vlerë kulturore të ish shkollës së fshatit Sfeçël.

Vendosja e emblemës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në memorialin e dëshmorëve në Penuhë.

### **Biblioteka e Qytetit**

Biblioteka e Qytetit është pasuruar me mbi 950 tituj të ri librash, në mbi 3000 kopje, gjysma e tyre e dhuruar nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Gjatë vitit 2022, në bibliotekë janë regjistruar 104 lexues të rinj, janë huazuar 1456 libra, kurse sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 2957 nxënës dhe studentë.

### **Aktivite Kulturore**

Janë organizuar aktivite për shënimin e datave të rëndësishme, si Përvjetori i Pavarësisë së Kosovës, 5 maji dita e dëshmorëve, 19 qershori dita e çlirimit të Komunës, 28 nëntori dita e flamurit kombëtar dhe organizimi i javës së diasporës, ku janë organizuar koncerte, janë dhënë shfaqje teatrore, janë shfaqur filma dhe janë organizuar aktivite sportive në fusha të ndryshme. Krahas tyre, janë organizuar aktivite kulturore siç janë: Organizimi i ditës së fëmijëve, Organizimi i takimeve kulturore “Kadri Kadriu, panairi i produkteve artizanale, paniri i librit dhe ekspozita e librit. Sikur cdo, sukseset e sportistëve tanë përmbledhen në organizimin vjetor të zgjedhjes së sportistit të vitit.

### **Aktivite Sportive**

Janë organizuar dhe mbështetur aktivite sportive dhe gara në futboll për djem dhe vajza, street ball, ecje malore, gara me vetura malore, në promovim të çiklizmit, karate, xhudo dhe në aktivite sportive për persona me nevoja të veçanta. Janë organizuar kampe në futboll, handboll, kik boks, volejball, basketboll dhe atletikë, me mysafirë nga Anglia dhe Gjermania, me qëllim të promovimit të sportit dhe talentëve të Komunës së Podujevës.

### **Aktivite Rinore**

Janë mbështetur me financa dhe logjistikë, organizata rinore, në të cilat janë zhvilluar aktivite edukative dhe rekreative për të rinjt.

## **Teatri “Avdush Hasani”**

Janë dhënë katër premiera të shfaqjeve të subvencionuara nga Komuna e Podujevës. Ka filluar bashkëpunimi në mes të Teatrit dhe Drejtorisë së Arsimit, për dhënien e shfaqjeve për nxënësit e shkollave. Janë dhënë 5 shfaqje mysafire. Në total, gjatë vitit 2022 janë dhënë gjithsej 25 shfaqje.

**Inicuar:** Në Ministrinë e Kulturës, janë inicuar kërkesa për ndërtimin e Palestrës së Sporteve, Pishinës Gjysmë Olimpike, Fushës së Atletikës, Fushave të Tenisit dhe restaurimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.



Drejtör:

Pajtim Balaj